V E N D I M
Nr. 272, datë 20.6.2002

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.418, DATË 9.7.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE TË FALIMENTUARA NË RRUGË ADMINISTRATIVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 48/1. të ligjit nr.8071, datë 25.10.1995, "Për procedurat e falimentimit", të ndryshuar me dekretin nr.1561, datë 25.7.1996, të miratuar në ligjin nr.8140, datë 5.9.1996, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kudo në vendimin nr.418, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, emërtimi "Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit" zëvendësohet me "Ministria përgjegjëse për industrisë".
2. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko